

Corona-Informacion për prindërit dhe nxënësit

Prej 16.03.2020 është pezulluar ligji për frekuentimin e shkollës në Sachsen. Gjatë kësaj jave do të mbyllën shkollat për një periudhë deri në fund të pushimeve të Pashkëve dt. 17.04.2020.

Periudha gjatë së cilës shkollat janë të mbyllura nuk është periudhë pushimesh, por për nxënësit do të organizohet një orar mësimor. Kjo do të thotë se, nga shkolla do të jepen dhe publikohen detyra, të cilat nxënësit do ti kryejnë vetë në mënyrë të pavarur në shtëpi. Këto detyra shtëpie do të kontrollohen nga mësuesët dhe do të vlerësohen. Për këtë arsye është e nevojshme informimi në mënyrë të rregullt nga faqet e internetit të shkollës (Homepage, LernSax , . . .)

Për klasat 1-4 në shkollat fillore dhe në shkollat specifike për nevoja të vecanta (Förderschule) do të krijohet mundësia e mbikqyrjes në rast nevoje. Kjo vlen për nxënësit, prindërit e të cilëve me profesionin e tyre mbulojnë nevojat e popullsisë në furnizim, në transportin e personave apo në kujdesin mjekësor dhe nuk kanë mundësi të tjera për kujdesin e fëmijëve në shtëpi.

Mësuesët kujdestarë gjatë kësaj periudhe mbeten personat kontaktit për prindërit dhe nxënësit. Në orarin 08:00-14:00 shkollat mund të kontaktohen me telefon.